

Embrace the Lord's Gift of Repentance

By Elder Jorge M. Alvarado
Of the Seventy

Përqafojeni Dhuratën e Zotit për Pendim

Nga Plaku Horhe M. Alvarado,
i Të Shtatëdhjetëve

October 2024 general conference

Let us not wait for things to get hard before turning to God. Let us not wait until the end of our mortal lives to truly repent.

I testify of a loving Heavenly Father. In the April 2019 general conference, moments after I was sustained in my new responsibility as a General Authority Seventy, the choir sang a rendition of “I Stand All Amazed” that pierced my heart and soul.

I marvel that he would descend from his throne divine

To rescue a soul so rebellious and proud as mine,

That he should extend his great love unto such as I,

Sufficient to own, to redeem, and to justify.

As I heard those words, I was all amazed. I felt that despite my inadequacies and flaws, the Lord blessed me to know that “in his strength I can do all things.”

The common feeling of inadequacy, weakness, or even unworthiness is something with which many of us sometimes struggle. I still struggle with this; I felt it the day I was called. I have felt it many times, and I still feel it right now speaking to you. However, I have learned that I am not alone with these feelings. In fact, there are many accounts in the scriptures of those who seem to have felt similar feelings. For example, we remember Nephi as a faithful and valiant servant of the Lord. At times, even he struggled with feelings of unworthiness, weakness, and inadequacy.

Le të mos presim që gjërat të vështirësohen përpara se t'i drejtohem Perëndisë! Le të mos presim fundin e jetës sonë në vdekshmëri për t'u penduar vërtet!

Dëshmoj për një Atë të dashur Qiellor. Në konferencën e përgjithshme të prillit 2019, pak çaste pasi u mbështeta në përgjegjësinë time të re si Autoritet i Përgjithshëm i Shtatëdhjetë, kori këndoi një interpretim të himnit “Qëndroj Plot Habi” që më depërtoi në zemër e shpirt.

“Çuditë t'mendoj se nga fron' i Tij Ai do zbres,

Shpëtim t'i sjell' shpirtit tim krenar edhe rebel,

Që ta shtrij' kaq shumë mbi mua dashurin' e Tij,

Aq sa shëlbim dhe përligjje të gjej' shpirti im.”

Ndërsa i dëgjoja ato fjalë, u mahnita i tëri. Ndjeva se pavarësisht nga papërshtatshmëritë dhe të metat e mia, Zoti më bekoj me këtë dijeni se “në fuqinë e tij unë mund të bëj të gjitha gjërat”.

Ndjenja e zakonshme e papërshtatshmërisë, dobësisë apo edhe padenjesisë është diçka të cilën shumë prej nesh ndonjëherë e vuajnë. Unë ende e vuaj këtë; e ndjeva ditën kur mora thirrjen. E kam ndier shumë herë, dhe e ndiej akoma edhe tani që po ju flas juve. Megjithatë, kam mësuar se nuk jam i vetmi që ndihet kështu. Në fakt, ka shumë rrëfime në shkrimet e shenjta të atyre që duket se kanë pasur ndjenja të ngjashme. Për shembull, kujtojmë Nefin si një shërbëtor besnik dhe trim të Zotit. Hera-herës, edhe ai i vuajti ndjenjat e padenjesisë, dobësisë dhe papërshtatshmërisë.

He said: "Notwithstanding the great goodness of the Lord, in showing me his great and marvelous works, my heart exclaimeth: O wretched man that I am! Yea, my heart sorroweth because of my flesh; my soul grieveth because of mine iniquities."

The Prophet Joseph Smith spoke of often feeling "condemned," in his youth, "for [his] weakness and imperfections." But Joseph's feelings of inadequacy and worry were part of what led him to ponder, study, learn, and pray. As you may remember, he went to pray in the grove near his home to find truth, peace, and forgiveness. He heard the Lord say: "Joseph, my son, thy sins are forgiven thee. Go thy way, walk in my statutes, and keep my commandments. Behold, I am the Lord of Glory. I was crucified for the world that all those who believe on my name may have eternal life."

Joseph's sincere desire to repent and seek the salvation of his soul helped him come to Jesus Christ and receive forgiveness of his sins. This continuous effort opened the door to the continuing Restoration of the gospel of Jesus Christ.

This remarkable experience of the Prophet Joseph Smith illustrates how feelings of weakness and inadequacy can help us recognize our fallen nature. If we are humble, this will help us come to recognize our dependence upon Jesus Christ and stir within our hearts a sincere desire to turn to the Savior and repent of our sins.

My friends, repentance is joy! Sweet repentance is part of a daily process through which, "line upon line, precept upon precept," the Lord teaches us to live a life centered in His teachings. Like Joseph and Nephi, we can "cry unto [God] for mercy; for he is mighty to save." He can fulfill any righteous desire or longing and can heal any wound in our lives.

In the Book of Mormon: Another Testament of Jesus Christ, you and I can find countless accounts of individuals who learned how to come unto Christ through sincere repentance.

I'd like to share with you an example of the tender mercies of the Lord through an experience that occurred in my beloved home island of Puerto Rico.

Ai tha: "Me gjithë mirësinë e madhe të Zotit, që më tregon mua veprat e tij të mëdha dhe të mrekullueshme, zemra ime bërtet: O, ç'njeri i mjerë që jam! Po, zemra ime brengoset për shkak të mishit tim; shpirti im pikëllohet për shkak të paudhësive të mia."

Profeti Jozef Smith foli për faktin se shpesh ndihej i "ndëshkuar", në rininë e tij, "për dobësinë dhe papërsosmëritë e [tij]". Por ndjenjat e Jozefit të papërshtatshmërisë dhe shqetësimit ishin pjesë e asaj që e shtyu atë të përsiaste, të studionte, të mësonte dhe të lutej. Siç mund ta mbani mend, ai shkoi të lutej në korijen afër shtëpisë së vet për të gjetur të vërtetën, paqe dhe falje. Ai e dëgjoi Zotin t'i thoshte: "Jozef, biri im, mëkatet e tua të janë falur. Shko në udhën tënde, sillu sipas statuteve të mia dhe zbatoji urdhërimet e mia. Vër re, unë jam Zoti i lavdisë. Unë u kryqëzova për botën që të gjithë ata që besojnë në emrin tim, të mund të kenë jetë të përjetshme."

Dëshira e sinqertë e Jozefit për t'u penduar dhe për të kërkuar shpëtim për shpirtin e tij e ndihmoi atë të vinte te Jezu Krishti dhe të merrte falje për mëkatet e tij. Kjo përpjekje e vazhdueshme hapi derën për Rivendosjen në vazhdimësi të ungjillit të Jezu Krishtit.

Kjo përvojë mbresëlënëse e Profetit Jozef Smith ilustron se si ndjenjat e dobësisë dhe papërshtatshmërisë mund të na ndihmojnë të njohim natyrën tonë të rënë. Nëse jemi të përlur, kjo do të na ndihmojë të kuptojmë varësinë tonë te Jezu Krishti, dhe të na ngjallë në zemër një dëshirë të sinqertë për t'u kthyer te Shpëtimtari dhe për t'u penduar për mëkatet tona.

Miq të mi, pendimi është gëzim! Pendimi i ëmbël është pjesë e një procesi të përditshëm nëpërmjet të cilit, "rresht pas rreshti, parim pas parimi", Zoti na mëson të jetojmë një jetë të përqendruar te mësimet e Tij. Sikurse Jozefi dhe Nefi, ne mund t'i "përgjëro[hemi] [Perëndisë] për mëshirë; pasi ai është i fuqishëm të shpëtojë". Ai mund të përmbushë çdo dëshirë ose përgjërëm të drejtë dhe mund të shërojë çdo plagë në jetën tonë.

Në Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit, ju dhe unë mund të gjejmë rrëfime të panumërta të individëve që mësuan se si të vinin te Krishti nëpërmjet pendimit të sinqertë.

Do të doja t'ju tregoja një shembull të mëshirave të dhembshura të Zotit nëpërmjet një përvoje që ndodhi në ishullin tim të dashur amtar, Porto-Riko.

It was in my hometown of Ponce that a sister in the Church, Célia Cruz Ayala, decided that she was going to give a Book of Mormon to a friend. She wrapped it and went to deliver this gift, more precious to her than diamonds or rubies, she said. On her way, a thief approached her, grabbed her purse, and ran away with the special gift inside.

When she told this story at church, her friend said, “Who knows? Maybe this was your opportunity to share the gospel!”

Well, a few days later, do you know what happened? Célia received a letter. I hold that letter, which Célia shared with me, in my hand today. It says:

“Mrs. Cruz:

“Forgive me, forgive me. You will never know how sorry I am for attacking you. But because of it, my life has changed and will continue to change.

“That book [the Book of Mormon] has helped me in my life. The dream of that man of God has shaken me. ... I am returning your five [dollars,] for I can't spend them. I want you to know that you seemed to have a radiance about you. That light seemed to stop me [from harming you, so] I ran away instead.

“I want you to know that you will see me again, but when you do, you won't recognize me, for I will be your brother. ... Here, where I live, I have to find the Lord and go to the church you belong to.

“The message you wrote in that book brought tears to my eyes. Since Wednesday night I have not been able to stop reading it. I have prayed and asked God to forgive me [and] I ask you to forgive me. ... I thought your wrapped gift was something I could sell. [Instead,] it has made me want to [change] my life. ... Forgive me, forgive me, I beg you.

“Your absent friend.”

Brothers and sisters, the light of the Savior can reach us all, no matter our circumstances. “It is not possible for you to sink lower than the infinite light of Christ's Atonement shines,” said President Jeffrey R. Holland.

As for the unintended recipient of Célia's gift, the Book of Mormon, this brother went on to witness more of the Lord's mercy. Although it took time for this brother to forgive himself, he found joy in repentance. What a miracle! One

Ishte në qytetin tim të lindjes, në Pons, që një motër në Kishë, Selia Kruz Ajala, vendosi t'ia jepte Librin e Mormonit një mikeshe. Ajo e mbështolli dhe shkoi ta dorëzonte këtë dhuratë, që për të ishte më e çmuar se diamantet apo rubinët. Rugës iu afrua një hajdut, ia grabiti çantën dhe ia mbathi me vrap me dhuratën e veçantë brenda.

Kur e tregoi këtë histori në kishë, mikesha e saj tha: “Ku i dihet? Mbase kjo që mundësia jote për të shpërndarë ungjillin!”

Epo, disa ditë më vonë, a e dini se çfarë ndodhi? Selia mori një letër. E mbaj në dorë sot atë letër, të cilën Selia ma tregoi. Aty thuhet:

“Znj. Kruz,

Të më falni, të më falni. Nuk e keni idenë sa keq më vjen që iu sulmova. Por për këtë shkak, jeta ime ka ndryshuar dhe do të vazhdojë të ndryshojë.

Ai libër [Libri i Mormonit] më ka ndihmuar në jetën time. Ëndrra e atij njeriu të Perëndisë më ka tronditur. ... Do t'jua kthej pesë [dollarët] tuaj, sepse nuk mund t'i shpenzoj. Dua që të dini se kishte një lloj shkëlqimi te ju. Ajo dritë dukej se më ndaloi [që të mos ju bëja keq, prandaj] ia mbatha me vrap.

Dua që të dini se do të më shihni përsëri, por gjer atëherë, nuk do të më njihni, sepse unë do të jem vëllai juaj. ... Këtu, ku jetoj, duhet të gjej Zotin dhe të shkoj në kishën ku ju bëni pjesë.

Mesazhi që kishit shkruar në atë libër, më përloti. Që nga mbrëmja e së mërkurës, nuk kam mundur të ndaloj së lexuari atë. Jam lutur dhe i kam kërkuar Perëndisë të më falë [dhe] ju kërkoj që edhe ju të më falni. ... Mendova se dhurata juaj e mbështjellë ishte diçka që mund ta shisja. [Por në fakt] më ka bërë të dëshiroj të [ndryshoj] jetën time. ... Ju lutem shumë të më falni.

Miku juaj anonim.”

Vëllezër dhe motra, drita e Shpëtimtarit mund të na arrijë të gjithëve, pavarësisht nga rrethanat tona. “Nuk është e mundur që ju të zhyteni më poshtë se [sa ku shkëlqen] drita e pafundme e Shlyerjes së Krishtit”, – tha Presidenti Xhefri R. Holland.

Sa për marrësin e paplanifikuar të dhuratës së Selias, Librit të Mormonit, ky vëlla vijoi të dëshmonte më shumë mëshirë prej Zotit. Edhe pse këtij vëllai iu desh kohë ta falte veten, ai gjeti gëzim gjatë pendimit. Çfarë mrekullie! Një motër

faithful sister, one Book of Mormon, sincere repentance, and the Savior's power led to the enjoyment of the fulness of blessings of the gospel and sacred covenants in the house of the Lord. Other family members followed and accepted sacred responsibilities in the Lord's vineyard, including full-time missionary service.

As we come unto Jesus Christ, our path of sincere repentance will eventually lead us to the Savior's holy temple.

What a righteous motive to strive to be clean—to be worthy of the fulness of the blessings made possible by our Heavenly Father and His Son through sacred temple covenants! Serving regularly in the house of the Lord and striving to keep the sacred covenants we make there will increase both our desire and our ability to experience the change of heart, might, mind, and soul necessary for us to become more like our Savior. President Russell M. Nelson has testified: "Nothing will open the heavens more [than worshipping in the temple]. Nothing!"

My dear friends, do you feel inadequate? Do you feel unworthy? Are you second-guessing yourself? Perhaps you might worry and ask: Do I measure up? Is it too late for me? Why do I keep failing when I am trying my absolute best?

Brothers and sisters, surely we will make mistakes in our lives along the way. But please remember that, as Elder Gerrit W. Gong has taught: "Our Savior's Atonement is infinite and eternal. Each of us strays and falls short. We may, for a time, lose our way. God lovingly assures us [that] no matter where we are or what we have done, there is no point of no return. He waits ready to embrace us."

As my dear wife, Cari Lu, has also taught me, we all need to repent, rewind, and reset the time to "zero o'clock" every single day.

Obstacles will come. Let us not wait for things to get hard before turning to God. Let us not wait until the end of our mortal lives to truly repent. Instead, let us now, no matter which part of the covenant path we are on, focus on the redemptive power of Jesus Christ and on Heavenly Father's desire for us to return to Him.

The Lord's house, His holy scriptures, His

besnike, një Libër i Mormonit, pendimi i sinqertë dhe fuqia e Shpëtimtarit çuan në gëzimin e plotësisë së bekimeve të ungjillit dhe besëlidhjeve të shenjta në shtëpinë e Zotit. Pjesëtarë të tjerë të familjes ndoqën dhe i pranuan përgjegjësitë e shenjta në vreshtin e Zotit, duke përfshirë shërbimin misionar kohëplotë.

Ndërsa vijmë te Jezu Krishti, shtegu ynë i pendimit të sinqertë do të na prijë përfundimisht drejt tempullit të shenjtë të Shpëtimtarit.

Çfarë motivi i drejtë për t'u përpjekur fort që të jemi të pastër, të jemi të denjë për plotësinë e bekimeve të mundësuar nga Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij nëpërmjet besëlidhjeve të shenjta të tempullit! Shërbimi i rregullt në shtëpinë e Zotit dhe përpjekja fort për t'i mbajtur besëlidhjet e shenjta që bëjmë atje, do t'i rritin dëshirën dhe aftësinë tonë për të përjetuar ndryshimin e zemrës, forcës, mendjes dhe shpirtit, të domosdoshme për t'u bërë më shumë si Shpëtimtari ynë. Presidenti Rasëll M. Nelson ka dëshmuar: "Asgjë nuk do t'i hapëmë shumëqiejt [sesa adhurimi në tempull]. Asgjë!"

Miq të mi të dashur, a ndiheni të papërshtatshëm? A ndiheni të padenjë? A jeni në dilemë me veten? Ndoshta mund të shqetësoheni e të pyesni: A jam në lartësinë e duhur? Mos është tepër vonë për mua? Pse vazhdoj të dështoj edhe pse po përpiqem me gjithë mundin tim?

Vëllezër dhe motra, sigurisht që gjatë udhës do të bëjmë gabime në jetën tonë. Por ju lutem, mbani mend se, siç ka dhënë mësim Plaku Gerit W. Gong: "Shlyerja e Shpëtimtarit tonë është e pafundme dhe e përjetshme. Secili prej nesh shkon në udhë të gabuar dhe dështon. Për njëfarë kohe, ne mund ta humbasim udhën. Perëndia plot dashuri na siguron [se], pavarësisht se ku jemi ose çfarë kemi bërë, ... nuk ka udhë pa kthim. Ai pret i gatshëm për të na përqafuar."

Siç më ka mësuar edhe gruaja ime e dashur, Keri Luja, ne të gjithë duhet të pendohemi, t'i rikthejmë dhe t'i kurdisim minutat te "ora zero" çdo ditë.

Pengesat do të vijnë. Le të mos presim që gjërat të vështirësohen përpara se t'i drejtohem Perëndisë! Le të mos presim fundin e jetës sonë në vdekshmëri për t'u penduar vërtet! Përkundrazi, pavarësisht se në cilën pjesë të shtegut të besëlidhjeve jemi, le të përqendrohemi tani te fuqia shëlbuese e Jezu Krishtit dhe te dëshira e Atit Qiellor për t'u rikthyer tek Ai.

Shtëpia e Zotit, shkrimet e Tij të shenjta,

holy prophets and apostles inspire us to strive towards personal holiness through the doctrine of Christ.

And Nephi said: "And now, behold, my beloved brethren, this is the way; and there is none other way nor name given under heaven whereby man [and woman] can be saved in the kingdom of God. And now, behold, this is the doctrine of Christ, and the only and true doctrine of the Father, and of the Son, and of the Holy Ghost."

Our process of "at-one-ment" with God may feel challenging. But you and I can pause, be still, look to the Savior, and seek to find and act on what He would have us change. If we do so with full intent, we will witness His healing. And think of how our posterity will be blessed as we embrace the Lord's gift of repentance!

The Master Potter, taught my dad, will mold and refine us, which can be difficult. Nonetheless, the Master Healer will also cleanse us. I have experienced and continue to experience that healing power. I testify that it comes through faith in Jesus Christ and daily repentance.

Oh, it is wonderful that he should care for me

Enough to die for me!

I testify of God's love and of the infinite power of His Son's Atonement. We can feel it profoundly as we sincerely and wholeheartedly repent.

My friends, I am a witness of the glorious Restoration of the gospel through the Prophet Joseph Smith and the current divine guidance of the Savior through His prophet and mouthpiece, President Russell M. Nelson. I know Jesus Christ lives and that He is the Master Healer of our souls. I know and I testify that these things are true, in the holy name of Jesus Christ, amen.

profetët dhe apostujt e Tij të shenjtë na frymëzojnë të përpiqemi fort drejt shenjtërisë personale nëpërmjet doktrinë së Krishtit.

Dhe Nefi tha: "Dhe tani, vini re, vëllezërit e mi të dashur, kjo është udha; dhe s'ka udhë tjetër dhe as emër të dhënë nën qiell, nëpërmjet të cilit njeriu mund të shpëtohet në mbretërinë e Perëndisë. Dhe tani, vini re, kjo është doktrina e Krishtit dhe e vetmja doktrinë e vërtetë e Atit dhe e Birit dhe e Frymës së Shenjtë."

Procesi ynë i "bërjes një" me Perëndinë, mund të na duket sfidues. Por ju dhe unë mund të ndalemi, të qëndrojmë, të shikojmë te Shpëtimtari dhe të kërkojmë të gjejmë dhe të veprojmë sipas asaj që Ai do të donte që ne të ndryshonim. Nëse e bëjmë këtë me qëllim të plotë, do të dëshmojmë shërimin e Tij. Mendoni se si do të bekohen pasardhësit tanë ndërsa e përqafojmë dhuratën e Zotit për pendim!

Poçari Mjeshtër, siç më mësoi babai, do të na japë formë dhe do të na rafinojë, gjë e cila mund të jetë e vështirë. Sidoqoftë, Shëruesi Mjeshtër do të na pastrojë gjithashtu. E kam përjetuar dhe vazhdoj ta përjetoj atë fuqi shëruese. Dëshmoj se ajo vjen nëpërmjet besimit te Jezu Krishti dhe pendimit të përditshëm.

"Kaq shumë t'kujdeset për mua, o ç'mrekulli!

Aq shumë sa u bë fli!"

Dëshmoj për dashurinë e Perëndisë dhe fuqinë e pafundme të Shlyerjes së Birit të Tij. Mund ta ndiejmë atë thellësisht ndërsa pendohe mi sinqerisht dhe me gjithë zemër.

Miq të e mi, unë jam dëshmitar i Rivendosjes së lavdishme të ungjillit nëpërmjet Profetit Jozef Smith dhe udhërrëfimit aktual hyjnor të Shpëtimtarit nëpërmjet profetit dhe zëdhënësit të Tij, Presidentit Rasëll M. Nelson. Unë e di se Jezu Krishti jeton dhe se Ai është Shëruesi Mjeshtër i shpirtave tanë. E di dhe dëshmoj se këto gjëra janë të vërteta, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.